



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e tretë 2023

Oda e Mjekëve të Kosovës



Shtator 2023 Prishtinë

Rr. QKUK, INSTITUTI A, KATI 3, 10000 Prishtinë, Kosovë, | +383 49 872 300 | info@omk-rks.org | www.omk-rks.org

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e tretë 2023	
1. Infrastruktura Juridike	
2. Këshilli Drejtues	
3. Anëtarësimi	
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	
5. Licencimet	
6. Këshilli Mbikëqyrës	
7. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	
8. Komisioni për Edukim Specialistik	
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke	
11. Raporti financiar	
11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 shtator 2023	
11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	
11.3 Prokurimi	
12. Aktivitete të tjera	
12.1 Botimi i Revistës Mjeku	
12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim	
12.3 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së	
12.4 Marrëdhëniet ndërkombëtare	
12.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	
13. Plani i veprimit për 2023	

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore korrik – shtator 2023, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime si dhe në 3 rast kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet/Për gjigjet sipas kërkesave/an kesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill-qershor	Vendime/Perg jigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	4	10	1	<p>-Vendim për aprovim të kërkesës së kryetarit për fillimin e procedurave negociuse të prokurimit të tenderit "Dokumentar për 10 vjetorin e themelimit të Odës;</p> <p>-Vendim për aprovim të propozimit të Kryetarit të OMK-së për linjën buxhetore e cila do të përdoret për organizimin e Ceremonisë së 10 vjetorit të OMK-së;</p> <p>-Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për shpalljen e tenderit për përzgjedhjen e Kompanisë Operatorit Ekonomik që do të ofroj hapsirat për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve të OMK-së;</p> <p>-Vendim për aprovim të kërkesës për zhvillimin e procedurës njëburimore sipas agjendës së ceremonis për organizim në vizit në Verarin Stone Castle;</p> <p>-Vendim për fillimin e procedurave të prokurimit për hapjen e tenderit për përzgjedhjen e OE për blerjen e biletave të avionit për udhëtimet zyrtare dhe aktivitetet e tjera të Odës.</p>	0

3. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore Korrik – Shtator 2023, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 93 mjekë, nga të cilët janë 2 mjekë të punësuar në sektorin publik, 5 mjekë të punësuar në sektorin privat, 82 mjekë të papunë dhe 1 mjekë në pension si dhe 3 mjekë kanë shkuar jashtë vendit.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën kohore Korrik – Shtator 2023




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 shtator 2023

Gjatë kësaj periudhe është ndarë nga jeta 1 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 13 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 shtator është 5356 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale


Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë Prokurorit të OMK-së, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e Prokurorit të OMK-së.

ORGANI	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM3	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM3	Sanksionet e shqiptuar për periudhën TM3	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM3	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	20	16	N/A	N/A	5	14
Këshilli Etik	14	5	Qortim Publik 2	1 Gjobë	5	22
Gjyqi i Nderit	2	2	///	///	0	0
Certifikatat e kaluarës etike	93	///	///	///	///	///

Me datë 20.09.2023 është mbajtur takimi i KES, në të cilin është diskutuar për një ankesë që e kanë adresuar disa specialistë të Klinikës Pediatrike për mbrojtje Juridike


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës Korrik - Shtator 2023 ka akredituar 31 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 7 prej këtyre akreditimeve janë me taksë administrative.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës Korrik - Shtator 2023, ka lëshuar 314 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Këshilli Mbikqyrës

Gjatë periudhës **korrik-shtator** 2023 Këshilli Mbikqyrës i OMK-së ka mbajtur pesë (3) takime ku i kanë shqyrtuar Vendimet e Këshillit Drejtues, Këshillit Etik, Prokurorit, Gjyqit të Nderit të OMKsë dhe të organeve të tjera të OMK-së, gjithashtu kanë dhënë rekomandime për përmirësimin e punës së OMK-së.

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore Korrik-Shtator 2023, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsej njezeteshtate (27) kërkesa për leje –hulumtime ku prej tyre gjashte (6) janë Raport kthimi pas realizimit të hulumtimit nga pala dhe janë marrë vendime aprovuese për keto raporte. Ndërkaq Komisioni për Çështje Etike i OMK-së, për 21 kërkesa tjera të shqyrtuara ka nxjerrë 19 vendime aprovuese dhe 2 vendime refuzuese.

9. Komisioni për Edukim Specialistik

Në periudhën kohore prill - qershor 2023, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur një (1) takim. Përgjatë këtij takimi komisioni ka diskutuar për Udhëzimin Administrativ për Shkollim Specialistik 01/2023.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore Korrik-Shtator 2023, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar dy (2) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë dy(2) vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga palët.

11. Raporti financiar

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 30 SHTATOR 2023

1.0 Të hyrat:				
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2022	€			
	810,867.00			
Total Paraja në bankë me 31.12.2022				€810,867
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€	€	€	€
	271,885	92,721	25,529	390,135
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€	€	€	€
	3,380	3,520	1,500	8,400
1.2.2 Licencimi	€	€	€	€
	20,250	14,130	14,430	48,810
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€	€	€	€
	11,229	11,777	68,396	91,402
Të hyrat deri me 30.09.2023	€ 306,744	€ 122,147	€ 109,855	€ 538,746
Paraja në bankë me 31.12.2022				€ 810,867
TOTAL TË HYRAT				€ 1,349,613

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	TOTAL
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	€	€		€
	66,904	57,578	68,762.60	193,245
2.2 Material shpenzues	€	€		€
	2,220	2,905	288.87	5,414
2.3 Reprezentacioni	€	€		€
	1,033	561	657.93	2,252
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€	€	€	€
	16,671	94,698	34,615	145,984
2.5 Shpenzimet e tjera*	€	€	€	€
	12,855	12,624	18,102	43,581
2.6 Shpenzimet e asetëve	€	€	€	€
	2,895	1,550	-	4,445
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€	€	€	€
	2,000	-	3,000	5,000
Llogarit e paueshme me 31.12.2022	€			€
	9,510			-
Llogarit e pagueshme me 30.06.2023	€	€		€
	(10,542)	(6,313)		-
TOTAL SHPENZIMET 30.09.2023	€ 103,546	€ 163,604	€ 125,426	€ 399,921
Neto të hyrat për TM 3 - 2023	€ 203,198	€ (41,456)	€ (15,571)	€ 138,826
TOTAL BILANCI 30.09.2023				€ 949,693

1.2.3* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Riregjistrim në regjistrin OMK, Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit,

Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera.

2.5*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

11.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore korrik – shtator 2023 u zhvillua procedura e negociuar për Team building, operatori ekonomik është zgjedh në muajin gusht.

Në muajin gusht, me procedurë të hapur është bërë përzgjedhja e operatorit ekonomik, kontratë për hapsirën e mbajtjes së ceremonisë së shënimit të 10 vjetorit të OMK-së.

Në muajin gusht u zhvillua procedura e negociuar e prokurimit, kontratë për dokumentarin e shënimit të 10 vjetorit të OMK-së.

Gjithashtu në muajin gusht u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata për akomodimin e të ftuarve në ceremoninë e shënimit të 10 vjetorit në OMK-së.

Në shtator u zhvillua me sukses procedura e prokurimit me vlera të vogla - Kontratë për ekspoziten e mjekut ndër vite.

Kontratë një burimore “Tenderi vizitë një ditore në verarinë e vendit tonë”.

12. Aktivitetet e tjera

Raport për tre muajorin e tretë, 2023.

Në muajin shtator u publikua numri i veçantë i Revista Mjeku, numër ky i dedikuar për 10 vjetorin e themelimit të OMK-së, që ka temën 10 Vite punë dhe përkushtim.

Ky numër është i përbërë nga intervista të ndryshme të përfaqësuesve të institucioneve relevante, duke filluar nga ish-ministrat e shëndetësisë, kontributdhënësit në ndërtimin dhe zhvillimin e OMK-së, si dhe artikuj nga OMK rreth konferencave, punës së kryer ndër vite, sondazh etj.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës në mënyrë që të arrijë audiencë më të gjerë, linkun e të cilës e gjeni të bashkangjitur më poshtë:

<https://omk-rks.org/ep-content/uploads/Oda-jon%C3%AB-10-vite-finale.pdf>

12.1 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në apektin profesional.

Në këtë drejtim Oda e Mjekëve në bashkpunim me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, kanë identifikuar nevojat për trajnime dhe si rezultat ka filluar procesi i rekrutimit të trajnerave të kualifikuar apo insitucioneve për të implementuar trajnimet e nevojshme.

Nga muaji korrik 2023 u organizua në QKUK trajnimi nga lëmia e laparaskopisë. Ky trajnim planifikohet të zgjatë katër muaj me pjesëmarrës mjekë të Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit. Qëllimi i trajnimit është aftësimi profesional i stafit për kryerjen e intervenimeve nga lëmia e laparaskopisë në Spitalin e Përgjithshëm Prizren. Poashtu reparti i Kirurgjisë i Spitalit të Përgjithshëm Prizren është nje ndër repartet model në Kosovë. Reparti i këtij spitali është renovuar në tërësi dhe është pajisur me aparturë modeme.

Ndërsa prej muajit Shtator 2023 u organizua në QKUK trajnimi nga lëmia e kardiologjisë intervente dhe planifikohet që trajnimi të zgjasë 4 deri në 6 muaj. Krijimi i departamentit të Kardiologjisë Intervente në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren është një projekt kombëtar i rëndësishëm për shëndetësinë publike.

Trajnimi ka fokus teknikat intervente (invazive) për trajtimin e sëmundjeve të zemrës dhe të enëve të gjakut. Ky trajnim do të sigurojë njohuri dhe aftësi të nevojshme për mjekët në fushën e kardiologjisë intervente, që do të ndihmojë krijimin e departamentit të Kardiologjisë Intervente në Spital Përgjithshëm në Prizren. Ky shërbim i ri do të rrisë kapacitetin e kujdesit shëndetësor në rajonin e Prizrenit dhe do të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në trajtimin e pacientëve me sëmundje të zemrës.

Projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 fillimisht ka alokuar vlerën prej 120,000.00€ kurse në fund të vitit 2022 pas suksesit të treguar nga OMK për realizimin e trajnimeve, marrëveshjes bazë i është shtuar amandamenti 1, ku janë alokuar mjete shtesë për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionaleprofilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Si pjesë e amandamentit 1 të marrëveshjes (DAFI KSV/017•21 2749), përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me përfaqësues nga projekti i Qeverisë së Luksemburgut për shëndetësi KSV/017 dhe përfaqësues nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilani dhe Prizrenit kanë vizituar Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje në Slloveni. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për të diskutuar dhe finalizuar marrëveshjen për realizimin e trajnimeve profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit. Mjekët e Spitalit të Gjilanit dhe Prizrenit do të përfitojnë nga marrëveshja e trajnimeve profesionale që do zgjasin sipas kërkesave dhe nevojave, e që kryesisht do të jenë të fokusuara nga lëmia e Kardiologjisë intervente, Laparaskopisë, Mjekësisë Emergjente dhe Menaxhimit shëndetësor dhe cilësisë të Spitaleve.

Me datë 17 mars 2023, OMK ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje nga Sllovenia për ngritjen e kapaciteteve klinike të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe gjithashtu do t'u mundësojë mjekëve të Spitaleve të Prizrenit të Gjilanit dhe Spitaleve Sllovene të përfitojnë dhe zhvillohen profesionalisht përmes shkëmbimit të përvojave.

Si pjesë e marrëveshjes me spitalet Sllovene në muajin shtator, mjekët dhe infermierët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit kanë marr pjesë në trajnim nga lëmia e Gastroenterologjisë në Spitalin e Murska Sobotas në Slloveni. Trajnimi Reparti intern njesia Gastroenterologji-Endoskopi).

Gjatë këtij trajnimi janë realizuar në bashkëpunim me trajnerët dhe stafin shëndetësor te Spitalit Murska Sobota procedurat endoskopike, si gastroskopi dhe kollonoskopi dijagnostike, polipektomi me vendosje të klipsave dhe pa, PEG (gastrostoma endoskopike perkutane), vendosja e klipsave tek gjakderdhjet. Gjithashtu fokus i trajnimit ka qenë edhe informimi për programin kombëtar të skiningut- testi feqe gjak okult për personat mbi moshë 50 vjecare në zbulimin e proceseve infiltrative në kolon.

Ndërsa në Spitalin e Përgjithshëm Prizren është organizuar trajnimi me temë shërbimet e Emergjencës dhe triazhimi. Trajnimi u organizua nën drejtimin e Dr. Matej Gajsek dhe infermiere Mirsada Osmani, të cilët kanë ligjëruar specifikisht për Sistemin e triazhimit Manchester, menaxhimi i traumave në Emergjencë, Principet e ATLS/ATCN, Intoksikimi, etj.

Ndërsa deri në fund të vitit janë planifikuar të organizohen 6 trajnime bashkëpunuese dhe vizita mes mjekëve të spitaleve Sllovene dhe mjekëve të Spitave të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Për secilën trajnim mjekët nga Kosova do të kenë mundësinë të vizitojnë spitalet në slloveni dhe të përfitojnë nga përvoja e organizimit të punës në këto spitale, ku gjithashtu ekipi i mjekëve nga Sllovenia do të kenë mundësinë të vizitojnë spitalet e Gjilanit dhe Prizrenit.

Në kuadër të marrëveshjes mes Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projektit Luxembourg Development KSV/017, është nënshkruar marrëveshje partneriteti me Spitalin Hayat në Bursa të Turqisë. Mjekët nga Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit dhe Gjilanit do të kenë mundësinë të mbajnë trajnime që do të zgjasin mbi një muaj e që në fokus do të kenë lëminë e Ortopedisë dhe Gjinekologjisë me Obstetrikë.

Si rezultat i kësaj marrëveshjes gjatë muajit Shtator një mjek ortoped nga Spitali i Përgjithshëm Gjilan dhe një mjek ortoped nga Spitali i Përgjithshëm Prizren kanë mbajtur trajnimin nga lëmia e ortopedise në Spitalin Hayat. Ky trajnim ka pasur fokus artroskopinë dhe artroplastikën e gjurit dhe krahut.

Ndërsa pas muajit Shtator është planifikuar të organizohet trajnimi nga lëmia e Gjinekologjisë dhe Obsterikës, ku pjesëmarrës do të jenë mjekët e Spitalit të Përgjithshëm Gjilan dhe Prizren.

12.2 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së

Në kuadër të marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve, është e përfshirë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së. Gjatë periudhës kohore Korrik Shtator 2023, janë organizuar trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, siç janë trajnimi për programin Microsoft Excel dhe Team Building, ku qëllimi i organizimit të këtyre trajnimeve ka qenë standardizimi i procedurave të operimit ditor administrativ. Kurse sipas planifikimit përgjatë këtij viti do të organizohen edhe trajnime profesionale. Këto trajnime do të kenë ndikim të rëndësishëm pozitiv në zhvillimin dhe organizimin administrativ dhe profesional të OMK-së dhe në ofrim të cilësisë së shërbimit.

12.3 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Në Shtator 2023, përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morrën pjesë në Simpoziumin e përvitshëm të ZEVA-s (Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore).

Nikoqiri i këtij takimi është Oda e Mjekëve e Gjermanisë. Mbledhja e sivjetshme po mbahet në Dusseldorf, me tema diskutimi si:

Simpoziumi i përvitshëm i ZEVA-s u mbahet në Dusseldorf, me tema diskutimi si Studimet bazike mjekësore dhe sigurimi i cilësisë në ngritjen e nivelit të shkollimit mjekësor, Mungesa e mjekëve në shtete e ndryshme si dhe plani për tu rritur numri i studentëve të mjekësisë, Mundësitë dhe sfidat e profesioneve të reja të asistencës mjekësore si dhe mjeksia komplementare dhe ajo alternative, ku pjesë e këtyre diskutimeve janë edhe Dr. Pleurat Sejdiu në prezantimin e raporteve rreth këtyre temave.

Forumi i Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore (ZEVA) është një takim i përvitshëm i cili siguron një forum për përfaqësuesit e odave të mjekëve nga rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore për të përmbushur dhe diskutuar çështje që shqetësojnë reciprokisht. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe temat e takimit të ardhshëm të ZEVA, kun ë mesin e shumë odave pjesëmarrëse duke ju falenderuar lobimit të përfaqësuesve nga Oda e Mjekëve të Kosovës, u njoftua se takimi i radhës i ZEVA-s (Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Juglindore) do të organizohet në Kosovë, ku nikoqir i takimit do të jetë Oda e Mjekëve të Kosovës. Gjatë këtij takimi do të diskutohen tema të rëndësishme dhe për të forcuar bashkëpunimin me odat tjera rajonale dhe të evropës.

12.4 Oda e Mjekëve të Kosovës – 10 Vite Punë dhe Përkushtim

Fillet e para për themelimin e Odës së Mjekëve janë shënuar nga viti 2010. E gjitha ka filluar si iniciativë e Odës së Mjekëve të Gjermanisë, pasi është vërejtur mungesa e përfaqësimit profesional të mjekëve në evente ndërkombëtare të karakterit shëndetësor.

Inagurimi i Odës së Mjekëve të Kosovës është bërë me datën 10 nëntor 2013. Andaj këtë vit Oda e Mjekëve të Kosovës shënon 10 vjetorin e themelimit.

Me datë 18 Shtator 2023 u organizuar ceremonia e shënimit të 10 vjetorit të themelimit të OMK-së ku te ftuar kishte edhe përfaqësuesit e Asociacionit Mjekësor Botëror, Komiteti i Përhershëm i Mjekëve të Evropës, Odës së Mjekëve të Gjermanisë, Urdhri i Mjekut Shqipëri, Oda e Mjekëve të Kroacisë, Oda e Mjekëve të Malit të Zi, Oda e Mjekëve të Maqedonia dhe përfaqësues të lartë të misionëve diplomatike në Kosovë.

Programi i ceremonisë së 10 vjetorit të themelimit të OMK-së ka përfshirë një sërë aktivitete, fjalime nga musafir të ftuar që na kanë përkrahur dhe ku kanë theksuar arritjet e odës ndër vite. Gjithashtu në këtë ceremoni u shfaq dokumentari me temë “Oda e Mjekëve të Kosovës ndër vite”, u mbajt një panel diskutimi me temë “The future of self-governance ëithin Medical Profession”.

Për të shënuar këtë moment historik u publikua Revista Mjeku me numrin ceremonial me temë “10 vjetori i OMK-së”, ku nxorri në pah dëshmitë, sfidat dhe arritjet e këtij udhëtimit 10 vjeçar të OMK-së, si dhe udhëtimin në zhvillim e mëtejshëm.

Ndër aktivitetet kryesore ishte edhe ekspozita me temë “Mjeku ndër vite”. Ekspozita përfshin një koleksion të fotografive që reflektojnë rrugën e gjatë të mjekëve të Kosovës, duke filluar nga demonstratat e '81, periudha e helmimeve të nxënësve në shkolla, ku mjekët treguan guximin dhe sakrificën, vazhduar me pamjet nga lufta e UÇK-së dhe duke arritur tek themelimi, ngritja dhe funksionalizimi i Odës së Mjekëve të Kosovës. Ky rrugëtim është një dëshmi e përkushtimit të tyre ndaj profesionit mjekësor dhe pasionit të tyre për të shërbyer shoqërinë dhe pacientët në kohërat më të vështira dhe sfiduese të historisë së tyre.

1.1 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën korrikshtator	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën korrikshtator	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën korrikshtator	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	11	11	12	5	6

13 Plani i veprimit për 2023

Projektet/Planet 2023

- Fillimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë” dhe OPSH-të.
- Fillimi i zbatimit të sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 2.5 vite.
- Organizimi i Kongresit të V multidisiplinar
- Fillimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim KSV/017-21 2749, faza e dytë për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve

- Hulumtim për vlerësimin e ngarkesës së sëmundjes kronike dhe sindrominit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve)